



Periodiku AMF

AMF bëhet nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n

Më 11 qershor 2009, gjatë Konferencës së 34^t vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Autoriteteve të Letrave me Vlerë (IOSCO) që u mbajt në Tel Aviv, AMF u bë nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n duke u bërë anëtare e organizatës me të drejta të plota.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - maj 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-maj, arritën shifrën 3,288,199 mijë lekë, përkundrajt 2,627,040 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 25.17% më shumë.

Vijon në faqen 3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet Konferenca e 20^{të} ndëreuropiane me temë "Konvergjenca nëpërmjet bashkëpunimit"

Në datat 4 dhe 5 qershor 2009 u zhvilluan punimet e Konferencës së 20^{të} ndëreuropiane në Bukuresht, Rumani me temë "Konvergjenca nëpërmjet bashkëpunimit". Kjo konferencë, e organizuar në bashkëpunim me Organizatën Ekonomike për Bashkëpunim dhe Zhvillim, trajtoi çështje të rëndësishme të zhvillimeve ndërkombëtare të sektorit të sigurimeve dhe qasjes së mbikëqyrjes ndaj tyre.

Vijon në faqen 5

Zhvillohet seminari mbi sigurimet e detyrueshme motorike, aspektet ligjore, tendencat e tregjeve dhe trajtimi i dëmeve.

Gjatë periudhës 25-26 qershor 2009, në Torino, u zhvillua seminari mbi sigurimet e detyrueshme motorike, aspektet ligjore, tendencat e tregjeve dhe trajtimi i dëmeve.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet seminari mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve

Banka Qendore e Hollandës, zhvilloi gjatë periudhës 15-17 qershor 2009, në Amsterdam, Hollandë, seminarin mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve. Qëllimi i seminarit ishte të ofronte një forum për kërkim dhe diskutim me autoritete kompetente, në lidhje me çështje si risku i menaxhimit të fondeve të pensioneve në kuadër të krizës financiare, prezantimi me legjislacionin në fuqi dhe njohja më në hollësi të sistemit Hollandez.

Vijon në faqen 7

Zhvillohet seminari mbi sistemet e menaxhimit të sigurisë së aseteve informatike dhe standardit ISO:27001

Korporata Ndërkombëtare Financiare, zhvilloi në 4 qershor 2009, në hotel "Tirana International", seminarin mbi sistemet e menaxhimit të sigurisë së aseteve informatike dhe standardit ISO:27001. Seminari trajtoi standardet e sigurisë së përgjithshme të aplikuara, si dhe standardet e sigurisë, të aplikuara në sistemet informatike e menaxhimit të këtyre standardeve.

Vijon në faqen 8

Edukimi i konsumatorit

Material për diskutim mbajtur nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit mbi sigurimet, perspektivë e forumit të CFO

(Pjesë e shkëputur nga: The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice, Vëllimi 33, nr.1, janar 2009)

Shqetësimet e Forumit të CFO lidhur me DP Ngjasime me parimet e përpunuara të Forumit të CFO

Propozimet e DP mund të mendohen si gjerësisht të ngjashme me Parimet e Përpunuara të Forumit të CFO

Vijon në faqen 9

Në këtë numër:

AMF bëhet nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

5

Edukimi i konsumatorit

9



AMF bëhet nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n



Konferenca e 34^t vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Autoriteteve të Letrave me Vlerë, Tel Aviv 2009

Më 11 qershor 2009, gjatë Konferencës së 34^t vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Autoriteteve të Letrave me Vlerë (IOSCO) që u mbajt në Tel Aviv, AMF u bë nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n duke u bërë anëtare e organizatës me të drejta të plota.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Kryetarja, Zj. Elisabeta Gjoni dhe nga përfaqësues të rangut të lartë të Autoritetit.

Ky anëtarësim është i një rëndësie të veçantë dhe vjen si kurorëzim i një pune të gjatë e intensive nga ana e AMF, shoqëruar me një proces të gjatë verifikimi, i cili solli nevojën e hartimit të një sërë aktesh rregullative. Kjo gjë hap rrugën e madhe të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet homologe në mbarë botën, duke shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri. Nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi

është një detyrim për të gjithë anëtarët e IOSCO-s dhe procesi i nënshkrimit të tij duhet të përfundonte brenda vitit 2010.



Ky Memorandum Mirëkuptimi përcakton kushtet në lidhje me asistencën dypalëshe dhe shkëmbimin e informacionit, për arsye zbatimit dhe arritjen e përputhjes me aktet ligjore dhe nënligjore respektive të juridiksionit të Autoriteteve. Dispozitat e tij nuk kanë si qëllim që të krijojnë detyrime ligjore apo të zënë vendin e legjislacionit vendas.

IOSCO u formua në vitin 1983 nga transformimi i paraardhësit të tij si një shoqatë rajonale ndër-amerikane (e formuar në 1974) në një organizëm të vërtetë të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Sot, IOSCO njihet si një vendosës i standardeve ndërkombëtare për tregun e letrave me vlerë. Anëtarësimi i gjerë i Organizatës rregullon më shumë se 90% të tregut botëror të titujve dhe IOSCO është forumi i bashkëpunimit më i rëndësishëm i botës për agjencitë rregullatore të letrave me vlerë. Anëtarët e IOSCO-s

rregullojnë më shumë se 100 juridiksione dhe numri i anëtarëve të Organizatës po rritet vazhdimisht.

Në 2002, IOSCO miratoi një Memorandum Shumëpalësh të Mirëkuptimit, i cili kishte si qëllim lehtësimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet komuniteteve të rregullatorëve të titujve. Viti 2005 ka qenë një vit i rëndësishëm për IOSCO-n. Organizata miratoi Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit si një standard për bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet rregullatorëve të letrave me vlerë dhe vendosi objektiva të qarta strategjike për të zgjeruar në mënyrë të shpejtë rrjetin e nënshkruesve të Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s brenda vitit 2010.


Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-maj 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-maj, arritën shifrën 3,288,199 mijë lekë, përkundrejt 2,627,040 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 25.17% më shumë.

Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 45.70% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 54.30% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 29.25% të sigurimeve të Jetës dhe 24.79% të

Struktura e tregut të sigurimeve, janar - maj 2009



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - maj (2008 - 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
Periudha janar-maj	2008	2009
A) Sigurimi i Jetës	220,112	284,496
B) Sigurimi i Jo - Jetës	2,406,928	3,003,703
Nga këto		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	1,617,797	1,785,553
b) Sigurimi Vullnetar	789,131	1,218,150
TOTAL	2,627,040	3,288,199

sigurimeve të Jo-Jetës.

Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës, sërish 91.62% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës.

Gjatë 5-mujorit të parë të 2009 u nënshkruan rreth 298,816 kontrata sigurimi, ose rreth 30.57% më shumë se në njëjtën periudhë të vitit 2008.


Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar-maj 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 62.37% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, në 5-mujorin e parë 2009, arritën 1,185,728 mijë lekë, ose 2.40% më shumë se në periudhën janar-maj 2008.

Në janar-maj 2009, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 519,303 mijë lekë, ose rreth 30.59% më shumë se në periudhën janar-maj 2008.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 5-mujorit të parë të 2009 arritën në 80,432 mijë lekë, apo 29.38% më shumë se në periudhën janar-maj 2008.



Sigurimet vullnetare

Në periudhën janar-maj 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,502,646 mijë lekë, ose 48.89% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,218,150 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 30.50%, të pasuara nga sigurimi kasko me 21.78%, sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 19.75% dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në janar-maj 2009 arritën në 173,893 mijë lekë, ose 82.52% më shumë se në periudhën janar-maj 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 75.14% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në 5-mujorin e parë të vitit 2009 arritën në rreth 284,496 mijë lekë, ose rreth 29.25% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 29.04% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 51.29% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-maj 2009 kapi vlerën 655,613 mijë lekë, ose 26.80% më shumë se në janar-maj të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorike me 588,377 mijë lekë, apo 89.74% të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një rritje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me 64.30% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 30.17%, krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2008.

Risigurime

Gjatë periudhës janar-maj 2009, të ardhurat nga primet e veprimtarisë risiguroese kapën vlerën 11,403 mijë lekë, të cilat i përkasin portofolave të sigurimit “Aksidente Personale” dhe “Kasko” e janë prime të shkruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera


Zhvillohet Konferenca e 20^{të} ndëreuropiane me

temë “Konvergjencia nëpërmjet bashkëpunimit”


Në datat 4 dhe 5 qershor 2009 u zhvilluan punimet e Konferencës së 20^{të} ndëreuropiane në Bukuresht, Rumani me temë “Konvergjencia nëpërmjet bashkëpunimit”. Kjo konferencë, e organizuar në bashkëpunim me Organizatën Ekonomike për Bashkëpunim dhe Zhvillim, trajtoi çështje të rëndësishme të zhvillimeve ndërkombëtare të sektorit të sigurimeve dhe qasjes së mbikëqyrjes ndaj tyre.

- o Përfaqësuesit rumunë, mikpritës të konferencës, bënë një paraqitje të plotë të ecurisë dhe çështjeve aktuale të tregut të tyre të sigurimeve dhe ndikimin e krizës financiare në uljen e primeve të sigurimit të jetës në vitin 2008. Tregu Rumun i sigurimeve të jo-jetës ngjason me tregun Shqiptar për orientimin drejt sigurimeve të detyrueshme motorrike dhe për potencialin shumë të madh të zhvillimit të segmenteve të tjera të sigurimit. Kapitali i huaj, kryesisht Evropian, është i pranishëm në 44 shoqëri të sigurimit në Rumani. Interes paraqiti përshkrimi i programit kombëtar të sigurimit të katastrofave, që gjendet në fazën e zbatimit, pas

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-maj 2009 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-maj 2009 (Jeta)



miratimit të të gjithë kuadrit ligjor përkatës. Risi për industrinë përbën edhe krijimi i institutit të manaxhimit të sigurimeve, që është mbështetur dhe financuar nga Komisioni



Konferenca e 20^{të} ndërvropiane "Konvergjencia nëpërmjet bashkëpunimit"

Në Konferencë morën pjesë përfaqësues nga AMF-ja, ndërsa ajo u ndoq me interes nga përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrës të rajonit, Evropës, SHBA dhe vende të tjera.



Rumun i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

- o Efektet e krizës financiare në tregjet ndërkombëtare të sigurimit dhe risigurimit përbën një nga temat kryesore të trajtuara në aktivitet. Në prezantimet e tij, Dr. Peter Braumuller, Drejtor i Divizionit të Sigurimeve dhe Pensioneve në Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë dhe Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të IAIS¹, theksoi (i) rëndësinë e forcimit të rregullimit dhe mbikëqyrjes në sigurime dhe (ii) rolin e bashkëpunimit ndërkufitar të mbikëqyrësve në trajtimin e çështjeve që lidhen me veprimtarinë ndërkufitare të sigurimeve, kompleksitetin e grupeve apo konglomerateve.

- o Vend të veçantë zuri në konferencë edhe trajtimi i Parimeve Bazë të Sigurimeve² të miratuara nga IAIS-i dhe rëndësia e përshtatjes së tyre në kërkesat rregullatore të vendeve anëtare, apo vëzhguese të IAIS-it. Zhvillimet e reja në standardin e Aftësisë Paguese II³ dhe diskutimet në strukturat përkatëse Evropiane, modeli Zviceran i matjes së aftësisë paguese dhe testet e paraljëmërimeve të hershme u trajtuan në nivel të lartë teknik në Konferencë.

- ¹ IAIS - Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve
- ² Parimet bazë të sigurimeve (ICP) janë miratuar nga IAIS-i në vitin 2003
- ³ Solvency II

Zhvillohet seminari mbi sigurimet e detyrueshme motorike, aspektet ligjore, tendencat e tregjeve dhe trajtimi i dëmeve.

Gjatë periudhës 25-26 qershor 2009, në Torino, u zhvillua seminari mbi sigurimet e detyrueshme motorike, aspektet ligjore, tendencat e tregjeve dhe trajtimi i dëmeve.

Ndër materialet me interes, të trajtuara gjatë seminarit, përmendim:

1. *Paraqitje e problematikave të veçanta të trajtimit të dëmeve dhe zgjidhje të mundshme të tyre në vende të ndryshme të Evropës:*
 - o Itali: Shpërndarje e rasteve të dëmeve nga jugu në veri me problematikën e shkeljeve/abuzimeve, të lidhura me llojet e aksidenteve dhe vendndodhjen e tyre.
 - o Francë: Problematika të trajtimit të dëmeve



lidhur me sistemin francez të rimbursimit të drejtpërdrejtë të detyrueshëm.

- o Gjermani: Problematika në lidhje me vlerësimin e dëmeve dhe zgjidhja e tyre nëpërmjet ofertave ekonomike në blerjen e mjeteve të reja.

- o Rumani: Problematika në lidhje me trajtimin e dëmeve për sigurime të tipologjisë kasko, probleme të lindura si rrjedhojë e bashkimit monetar, problematika të lidhura me tipologji të veçanta shkelejesh/abuzimesh ndaj sigurimeve. Problematika të 'tkurrjes' së tregut të sigurimeve si rrjedhojë e krizës financiare.

2. *Ndikimi i krizës ekonomike në tregun e sigurimeve dhe zhvillime të mundshme.*

- o Hyrja në tregun e sigurimeve motorike të aktorëve të rinj: banka, prodhues automjeteve, etj.

- o Shfrytëzim i mundësisë së rivlerësimit të tregjeve të sigurimeve të lidhur me efektet e krizës financiare.

3. *Kuadri ligjor i Bashkimit Evropian në lidhje me trajtimin e dëmeve në kuadër të lëvizjes së lirë të mjeteve.*

- o Direktiva e IV e BE për trajtimin e dëmeve.

4. *Sistemet e teknologjisë së informacionit dhe mundësitë e tyre në integrim me sigurimet motorike.*

- o Sistemet si rregullatorë e menaxhues të riskut të marrë në sigurim.

- o Direktivat e BE-së mbi sigurinë motorike dhe privatësinë.

- o Sisteme teknologjike informacioni të integruar me shoqëri sigurimesh:

- (a) 'Pay as you drive': element 'black box' që

përmban memorje të lëvizjeve, shpejtësisë, nxitimit, orareve, tipit të rrugës dhe cakton nëpërmjet tyre shkallën e riskut të marrjes në sigurim.

- (b) Sisteme të integruar 'Tele ndihmë' në shërbim të rasteve të avarive, dëmeve, etj.

Eksperienca e marrë në kuadër të seminarit të prezantuar është në shërbim të krijimit dhe përmirësimit të Regjistrimit të Dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike, si faza e dytë e Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik. Regjistri i Dëmeve është projektuar nga AMF në bashkëpunim me Shoqëritë e Sigurimit dhe B.Sh.S, me qëllim kryesor mundësimin e krijimit të sistemit Bonus-Malus, duke përdorur si një nga parametrat e tij, historikun e dëmeve. Ekzistenca e një baze historike të dhënash mbi dëmet mundëson liberalizimin e mundshëm të tarifave ose kalimin e mirëfilltë në përjasjen "Risk-Based" për përlogaritjen e kapitalit minimal të kërkuar për këto portofole, në varësi të riskut të marrë në sigurim. Gjithashtu, regjistri do të mundësojë luftën ndaj shkelejeve/abuzimeve dhe raporte të ndryshme statistikore, në shërbim të përmirësimit të tregut të sigurimeve dhe shërbimeve të tij. Marrja e eksperiencës më të gjerë në trajtimin e dëmeve, mundëson një projekt afatgjatë dhe funksional në lidhje me problematikat ekzistuese në tregjet që na rrethojnë e drejt të cilëve dhe tregu shqiptar i sigurimeve lëviz si pjesë e pandarë e gjithë vendit.

Zhvillohet seminari mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve

Banka Qendore e Hollandës, zhvilloi gjatë periudhës 15-17 qershor 2009, në Amsterdam, Hollandë, seminarin mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve.

Qëllimi i seminarit ishte të ofronte një forum për kërkim dhe diskutim me autoritete kompetente, në lidhje me çështje si risku i menaxhimit të fondeve të pensioneve në kuadër të krizës

financiare, prezantimi me legjislacionin në fuqi dhe njohja më në hollësi të sistemit Hollandez. Gjatë zhvillimit të seminarit u trajtuan çështje të ndryshme në lidhje me mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve në kuadër të krizës financiare. Ndër më kryesoret që u diskutuan, ishin:

- o Prezantimi me sistemin Hollandez të pensioneve.
- o Vlerësimi financiar (metoda e menaxhimit të riskut financiar).
- o Legjislacioni i sistemit të pensioneve dhe policat e sigurimit.
- o Sistemi Hollandez i pensioneve në perspektivën Evropiane.
- o Efektet e krizës financiare mbi mbikëqyrjen.

Gjatë trajtimit të këtyre çështjeve, një rëndësi e veçantë ju kushtua menaxhimit të fondeve në kuadër të krizës financiare, ku si risi e sistemit Hollandez ishte marrja e shoqërive të nënkontraktuara për të menaxhuar fondet e pensioneve. Legjislacioni në fuqi lejonte një shoqëri menaxhimi fondesh pensioni të merrte një shoqëri të jashtme ose të nënkontraktuar për administrimin e fondeve ose investimin e tyre.

Pjesëmarrësit në seminar u ndanë në grupe punë dhe dhanë zgjidhje për disa çështje në lidhje me mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve, ku më pas u bë dhe vlerësimi i njohurive të përgjithshme marrë gjatë seminarit.

Ky organizim dha mundësinë për vendosjen në pozitën e mbikëqyrësve të fondeve të pensioneve, propozimin për zgjidhje konkrete mbi problemet aktuale të sistemit të pensioneve.

Zhvillohet seminari mbi sistemet e menaxhimit të sigurisë së aseteve informatike dhe standardit ISO:27001

Korporata Ndërkombëtare Financiare, zhvilloi në 4 qershor 2009, në hotel “Tirana International”, seminarin mbi sistemet e menaxhimit të sigurisë së aseteve informatike dhe standardit ISO:27001. Seminari trajtoi standardet e sigurisë së përgjithshme të aplikuara, si dhe standardet e sigurisë, të aplikuara në sistemet informatike e menaxhimit të këtyre standardeve.

Standardi i Menaxhimit të Sigurisë, i zhvilluar në tetor 2005, nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit, ISO, në mënyrë formale specifikon një sistem menaxhimi, qëllimi i të cilit është të kontrollojë në mënyrë eksplicite menaxhimin e sigurisë së informacionit.

Organizatat, të cilat reklamojnë adoptimin e ISO/IEC 27001, mund të auditohen dhe të certifikohen nga palë të treta të autorizuara për këtë proces.

Shumica e organizatave ka një diversitet të caktuar të kontroleve të sigurisë së informacionit. Pa një sistem drejtues sigurie informacioni, kontrollet e sigurisë priren të jenë disi të çorganizuara dhe të palidhur me njëri tjetrin, duke qenë se shpeshherë zbatohen në mënyrë ad-hoc si pasojë e kërkesave të çastit dhe jo në një këndvështrim afatgjatë. Kontrollet e sigurisë në veprim, zakonisht adresojnë disa aspekte të të dhënave të sigurisë ose TI, veçanërisht, duke i lënë asetet informatike jo-TI (të tilla si dhe dokumentet fizike, shkresat, njohuritë e printuara) edhe më pak të mbrojtur në tërësi. Për këtë është e nevojshme që dy aspektet, Siguria e Informacionit dhe Vazhdimësia e Biznesit, të trajtohen në një aspekt më të gjerë se sa Siguria dhe Vazhdimësia e TI dhe të jenë të koordinuara dhe të uniformizuara mes tyre.

Në seminar u paraqitën ide interesante mbi aspektet e sigurisë së informacionit elektronik dhe jo elektronik, si dhe standardet e ndjekura në këtë

fushë. Duke i studiuar këto standarde është e mundur krijimi i një perimetri sigurie të informacionit duke u ruajtur nga kërcënimet e mundshme, qofshin këto të qëllimshme apo gabime njerëzore, ose të brendshme apo të jashtme. Pjesa më e madhe e standardeve të sigurisë së informacionit është e lidhur ngushtë me TI, duke qenë se në ditët e sotme, informacioni që një organizatë disponon është në natyrë elektronike. Zbatimi i këtyre standardeve të sigurisë bëhet fillimisht jo vetëm në departamentin e TI, por kryesisht në biznesin vetë, pasi do jenë përdoruesit e biznesi, të cilët do bëjnë klasifikimin e informacionit dhe të tipeve të tij në disa shkallë rëndësie apo sensitiviteti. Më pas, TI mund të bëjë zbatimin e shkallëve të sigurisë në politika të caktuara informatike.

Nga ky seminar u përfitua njohja e standardeve kryesore të sigurisë të aplikuara në Evropë apo në Sh.B.A, si dhe në rrugën e cila duhet të ndiqet në zbatimin e tyre. Kjo strategji ka gjetur prej kohësh zbatim të pjesshëm në asetet informatike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si më poshtë:

- o *Kufizimi i privilegjeve dhe të drejtave të përdoruesve normalë të rrjetit informatik në AMF.* Përdoruesit nuk kanë të drejtë të instalojnë programe, të ndryshojnë konfiguracionin e sistemit operativ të kompjuterit të tyre, të ndryshojnë të drejtat e tyre në direktori, etj.
- o *Kufizimi i trafikut hyrës dhe dalës në internet.* Sistemet firewall në AMF bllokojnë shumicën e trafikut të konsideruar të rrezikshëm dhe kërcënues drejt AMF, si dhe bllokojnë një pjesë të mirë të trafikut të palejuar në dalje të rrjetit të AMF.
- o *Kufizimi i hapësirës së përbashkët në rrjet.* Çdo përdorues i AMF, në hapësirën e përbashkët, ka të drejta që të shohë vetëm dokumentet që kanë të bëjnë me profilin e tij të punës dhe nuk mund

të shohë dokumentet e të tjerëve. Çdo veprim i privilegjuar si fshirje dokumentesh, kopjim është plotësisht i audituar.

- o *Auditimi i sistemeve të komunikimit si posta elektronike, interneti, trafiku hyrës.*
- o *Kufizimi i të drejtave të sistemeve specifike.*

Zbatimi i mëtejshëm i standardeve të sigurisë në Autoritet, ka të bëjë me klasifikimin e informacionit dhe të tipeve të informacionit, në varësi të rëndësisë dhe të sekretit të tyre.

Edukimi i konsumatorit

...Vijon nga numri i kaluar

Material për diskutim mbajtur nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit mbi sigurimet, perspektivë e forumit të CFO
(Pjesë e shkëputur nga: The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice, Vëllimi 33, nr.1, janar 2009)

Shqetësimet e Forumit të CFO lidhur me DP
Ngjasime me parimet e përpunuara të Forumit të CFO

Propozimet e DP mund të mendohen si gjerësisht të ngjashme me Parimet e Përpunuara të Forumit të CFO:

- o Një model unik llogaritje për sigurimin e jetës dhe jo-jetës.
- o Përjasje sipas tre shtyllave të njëjta: Flukset e pritshme në të ardhmen të parasë, të zbritura me normën pa risk (risk-free, plus një marzhpër risk dhe pasiguritë.
- o Metodë sipas vlerës së tregut.
- o Vlerë aktuale (e hapur ndaj supozimeve në çdo mbyllje të bursës), por ka dhe diferenca thelbësore ndërmjet DP së IASB dhe EPs.



Përveç koncepteve të përgjithshme, ka diferenca të mëdha me EPs. Këndvështrimet e IASB janë të bazuara mbi koncepte teorike, të cilat nuk marrin në konsideratë jetën e vërtetë dhe propozimet e tij përmbajnë mangësi thelbësore. Kjo është e ilustruar në pjesën e mëposhtme, në të cilën janë prezente disa çështje themelore: *Flukse të ardhshme të parasë, tregu kundër supozimeve për entitete specifike, marzhi i shërbimeve dhe njohja e fitimit*. Ka dhe disa fusha të tjera, në të cilat propozimet e Bordit janë të ndryshme nga EPs, duke përfshirë për shembull ndarjen dhe pjesën e mbetur të kreditit vetjak.

Flukset e ardhshme të parasë

Trajtimi i bërë tek DP do të limitonte mundësinë për prime të ardhshme, dhe, potencialisht, aftësinë për të njohur të gjitha pagesat e pritshme tek policmbajtësit me kontrata pjesëmarrje, kjo do të çonte në flukse të konsiderueshme të parasë të përjashtuara nga vlera e kontratës:

- o Ndërkohë që lejohet për disa lloj marrëdhëniesh kontraktuale me konsumatorin, DP limiton njohjen e primeve të ardhshme dhe nuk lejon për një metodë të fortë ekonomike si tek një vlerësim transferimi, p.sh rasti i kontratave universale të jetës ose i kontratave të pensioneve të shtyra në kohë.
- o Tek DP, të drejtat për pjesëmarrje duhet të njihen vetëm nëse ekziston një angazhim i detyrueshëm dhe, që nuk varet nga ekzistenca e ndonjë detyrimi ekonomik, kriter ky që do të ishte marrë në konsideratë tek një transferim.

Metoda e vlerës së tregut (Market consistent)

Si DP ashtu dhe EPs mbështesin përdorimin e supozimeve me bazë tregun. DP propozon se të gjitha vlerësimet, përfshirë kostot e mbajtjes së kontratave dhe dëmeve, duhet të bazohen në të dhënat e tregut ose portofolit

dhe jo tek të dhënat specifike të subjektit:

- o Në fusha ku ka një evidencë të qartë të ekzistencës së tregut, propozimet e DP dhe EPs janë të ngjashme, kjo përfshin të dhënat financiare, si p.sh, normat e interesit, inflacionin e të dhënat makroekonomike.
- o Pikëpamjet e forumit CFO dhe DP janë gjithashtu të ngjashme lidhur me të dhënat e portofolit, si p.sh tabelat e mortaliteteve dhe dëmeve të ndodhura.
- o Megjithatë, në fusha të tjera, Forumi i CFO është i mendimit që supozimet duhet të bazohen në atë se çfarë subjekti pret të ndodhë, se sa tek modeli i krahasimit të një tregu hipotetik siç propozohet në DP.
- o Në veçanti, ky është rasti i shpenzimeve, ku të dhënat në dispozicion të tregut nuk janë shumë të besueshme. Metoda e një tregu me një efikasitet mesatare do të ishte jo-praktike, jo-ekonomike dhe do të shkaktonte diskutime të mëdha me auditorin. Edhe pse IASB sugjeron që në praktikë siguruesit do t'i referohen përgjithësisht kostove të tyre të shërbimit, ne jemi të shqetësuar sepse kjo do të vendoste një detyrim tek siguruesit që të provojnë që kostot e tyre nuk janë në mënyrë thelbësore të ndryshme nga kostot e pjesëmarrësve në treg.
- o Në vijim, kjo metodë teorike do të rezultojë në një informacion që nuk është as i kuptueshëm dhe as i rëndësishëm për përdoruesit, duke supozuar që shpenzimet mund të planifikohen mbi një efikasitet mesatare të tregut dhe duke lejuar fitime artificiale (nëse siguruesi është më pak efikas se tregu) ose humbje artificiale (nëse siguruesi është më shumë efikas se tregu) për t'u njohur në fillim dhe pastaj si kompensim gjatë kohës së kontratave kur njihen shpenzimet aktuale, ne vëmë në pikëpyetje kuptimin e informacionit

financiar bazuar në shpenzime teorike.

Marzhi i shërbimit

DP merr në konsideratë një marzh shërbimi përveç marzhit të riskut.

- o Ky koncept do të aplikohet tek shërbimet e tjera të siguruara nga siguruesit, si pjesë e kontratës, siç është menaxhimi i investimeve.
- o Sipas IASB, ashtu si dhe marzhi i riskut për riskun e sigurimeve, marzhi i shërbimit duhet të reflektojë koston që siguruesit duhet të paguajnë për të transferuar tek një palë tjetër pjesën e mbetur të shërbimeve.
- o E thënë në një mënyrë ndryshe, marzhi i shërbimit duhet të korrespondojë me një element kompensimi që një palë e tretë duhet të kërkojë për të bërë këto shërbime (siç është marzhi i riskut për mbajtjen e risqeve në sigurime).

Më qartë, ai marzh shërbimi nuk është në pajtueshmëri me metodat ekzistuese të vlerës së transferimit, p.sh me metodologjinë e mirëndërtuar të vlerës së integruar (metodë vlerësimi konservative llogaritet duke i shtuar aftësisë paguese vlerën e tashme të fitimit të pritshëm) e cila përdoret si referencë në vlerësimin e transferimit dhe gjithashtu në projektin e Sovency II, ku llogaritja e detyrimeve është bazuar në metodën e transferimit dhe përfshin vetëm marzhin e riskut. “Vlera e provigjoneve teknike duhet të jetë e barabartë me shumën e vlerësimi më të mirë dhe marzhit të riskut.

Marzhi i riskut duhet të jetë i tillë që të sigurojë, që vlera e provigjoneve teknike të jetë ekuivalente me sasinë e marrëveshjeve të sigurimit dhe të risigurimit, të cilat priten të ndërmerren në mënyrë që të përmbushen detyrimet e sigurimit dhe risigurimit”. Çdo marzh shtesë nga marzhi i riskut nuk do të

transferohet tek një sigurues tjetër, por do të mbahet nga dhënësi. Shtimi i një marzhi shërbimi shumë që duhet të transferohet nuk do të përfaqësojë një vlerësim ekonomik, por do të ketë pasoja në rritjen e padrejtë të shumës së detyrimeve tek policmbajtësit për t’u njohur në pasqyrat financiare të siguruesve.

Elementet e marzhit të propozuar të shërbimit, në fakt janë marrë nga (i) vlerësimi më i mirë i flukseve të ardhshme të parasë, të cilët tashmë përfshijnë elementet e kostos së shërbimit, dhe (ii) në marzhin e riskut, i cili reflekton elemente të kompensimit edhe për mbajtjen e riskut edhe (padyshim) për kryerjen e shërbimeve lidhur me kontratat e sigurimit. Pjesa tjetër është pjesë e marzhit të fitimit fillestar, që është, diferenca ndërmjet çmimit të hyrjes (primet) kostot neto të marrjes në sigurim dhe të çmimit të daljes (vlera e transferimit sipas vlerës së tregut) përbërë nga shumata e zbritur e vlerësimeve më të mira të flukseve të ardhshme të parasë plus marzhin e riskut.

Aktualisht, pyetja që shtrohet është: Nëse ky marzh i fitimit fillestar është i konsiderueshëm dhe si duhet të njihet fitimi? Kjo çështje e rëndësishme është trajtuar në pjesën e mëposhtme.

Njohja e Fitimit

Modeli i njohjes së fitimit është adresuar vetëm indirekt në DP (është trajtuar vetëm në pak paragrafë dhe nuk ka asnjë kërkesë specifike për koment) edhe pse kjo është një çështje kritike (ne theksojmë se IASB ka qenë shumë e përçarë mbi këtë subjekt, shtatë anëtarë mbështetën njohjen e fitimit në fillim të periudhës, kundrejt gjashtë anëtarëve dhe një abstenimi).

Si rrjedhojë e modelit të vlerës aktuale të daljes, DP lejon për ditën 1 njohjen e çdo marzhi fillestar fitimi.



Gjithsesi, sipas IASB, nuk duhet të ketë ndonjë diferencë thelbësore ndërmjet çmimeve të hyrjes dhe të daljes për kontratat e sigurimit dhe rrjedhimisht nuk ekziston ndonjë fitim thelbësor, i cili duhet të njihet që në fillim.

- o DP është e bazuar në këndvështrimin e IASB që ka një treg të vetëm për kontratat e sigurimit, si dhe për çdo instrument financiar, si p.sh. për fondin e garancisë së listuar. Bordi nuk bën dallim midis tregut me pakicë⁵ (ndërmjet policmbajtësve dhe siguruesve) dhe tregut me shumicë⁶ (ndërmjet siguruesve, aty ku transfertat rastësore mund të ndodhin), në këndvështrimin e tij, çmimi hyrës në tregun me pakicë duhet të barazojë çmimin dalës në tregun me shumicë.

- o Nqs ka fitime të shitjes me pakicë, të cilat tejkalojnë në mënyrë sinjifikative fitimet e shitjes me shumicë, kjo nuk do të zgjasë në kohë si pasojë e ligjit të çmimit të ofruar për blerje dhe të kërkuar për shitje dhe konkurrencës ndërmjet siguruesve për aksionet e tregut.

- o Në këndvështrimin e Bordit, duke përfshirë rastet në kushte të jashtëzakonshme (p.sh. tregu niche), diferenca ndërmjet çmimit hyrës dhe çmimit dalës duhet të rezultojë vetëm nga kostot e transaksionit (siç është në tregjet e bursave), nëse ka diferenca të tjera midis çmimit hyrës dhe çmimit dalës, kjo nuk do të lidhet me detyrimin që rrjedh nga kontrata e sigurimit por me “tarifa” për shërbime të veçanta të kryera në fillim.

- o DP është e paqartë në atë se çfarë mund të jenë këto shërbime të veçanta që i bëhen policmbajtësve në fillim. Ai propozon një shpjegim të bazuar në kompensimin që siguruesi duhet të bëjë për portfolet e grumbulluara (i cili është biznesi kryesor i sigurimit, por risku të ndahet në mënyrë të ndërsjelltë dhe kjo në një mënyrë të përhershme

gjatë gjithë kohës së kontratës dhe jo vetëm në fillim).

- o Për faktin se siguruesit mund ta kenë përçarur këtë vlerë të shtuar në fillim, duhet të justifikohet njohja në fillim në pasqyrën e të ardhurave/shpenzimeve të “tarifave” korresponduse të përfshira në “çmimin hyrës”.

Industria nuk i mbështet këto këndvështrime dhe thekson që aty ka një diferencë të theksuar ndërmjet çmimit të hyrjes, e vënë re në transaksionet me policmbajtësit, dhe çmimit të daljes në një transaksion ndërmjet siguruesve. Kjo ndodh sepse ka dy lloje tregjesh të ndryshme: Tregu i shitjes me pakicë dhe tregjet e shitjes me shumicë, si dhe për çdo të mirë dhe shërbim tjetër, çmimet janë të ndryshme në varësi të tregut, në të cilën kryhen transaksionet. P.sh. për patatet, çmimi tek dyqani në cep të rrugës është më i lartë se sa ato tek qendra rajonale e shitjes me shumicë, në të cilën të gjithë dyqanet marrin furnizimet e tyre.

Për të ilustruar materialin e marzhit fillestar të fitimit në sigurime, ne mund të përdorim si përaftrim llogaritjet e bëra me metodën e vlerësimit konservative, vlerë e cila llogaritet duke i shtuar aftësisë paguese vlerën e tashme të fitimit të pritshëm. Në vitin 2006, 11 anëtarë të forumit CFO prodhuan shifra EEV mbi metodën e vlerës së tregut⁷.

- Për biznesin e ri të regjistruar në vitin 2006, marzhi agregat fillestar i fitimit (vlera e biznesit të ri) për këto 11 sigurues ishte mbi 5.2 miliardë euro.
- Kjo përfaqëson rreth 4.5% të primeve të marra nga bizneset e reja të regjistruara brenda vitit, ose 2.4% të vlerës aktuale të të gjitha primeve që priten të merren gjatë jetës së biznesit (gjithashtu ekzistojnë dhe marzhe shtesë për gjeneratat e mëparshme të biznesit).

Siguruesit Evropianë bien dakort mbi mënyrën e llogaritjes. Ata janë duke mbështetur një model të vlerës së daljes që bazohet në trajtimin si një transferim për vlerësimin e përgjegjësive të sigurimit në pasqyrën e bilancit (në përputhje me vlerësimin e aktiveve me vlerë tregu).

Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që marzhi fillestar i fitimit si shtesë e vlerës së transferimit duhet të njihet në fillim si fitim në pasqyrën e të ardhurave/shpenzimeve. Fitimi nuk është fituar nëpërmjet veprimit të shitjes së kontratave të sigurimit por vetëm kur ka përfunduar përmbushja e kryerjes së shërbimeve tek policmbajtësi. Kjo është arsyeja pse EPs propozon që fitimi duhet të njihet kur është çliruar nga risku dhe kur janë kryer shërbimet përkatëse gjatë periudhës së kontratave. Kjo është në përputhshmëri me njohjen e fitimit për shërbimet sipas standardeve të IASB.

Kjo nuk është një çështje për llogaritje por një çështje prezantimi. Forumi i CFO ka konsideruar tre alternativa për klasifikimin dhe njohjen e marzhit fillestar të fitimit:

- Si komponent i veçantë i detyrimeve, veç detyrimeve ndaj policmbajtësve dhe të shfaqura në mënyrë të ndarë.
- Si komponent i veçantë i kapitalit të aksionarëve.
- Si fitim i njohur direkt në fillim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- o Zgjidhja e dhënë së fundmi, njohja e fitimit në ditën 1, nuk është në përputhje me këndvështrimin, që fitimi duhet të njihet gjatë gjithë kohës së kontratave dhe është në kontradiktë me EPs. Për më tepër, ndërkohë që kjo zgjidhje është e mundshme nga Solvency II, rregullatorët në sigurime dhe mbikëqyrësit mund të ngurronin ta pranonin

atë dhe mund të vinin në pikëpyetje marzhin fillestar të fitimit, ata mund të jenë të prirur të rrisin marzhin e riskut dhe kjo nuk të çon drejt një fitimi të madh në fillim.

o Opsioni i parë dhe i dytë ndryshojnë vetëm në prezantimin fillestar të marzhit të fitimit në kapitalin e vet ose në detyrime. Në të dyja mënyrat e zgjidhjes, marzhi i fitimit do të merret nga pasqyrat e të ardhura/shpenzimeve kur është i çliruar nga risku dhe shërbimet e bëra tek policmbajtësit. Këto dy përfundime janë në përputhje me këndvështrimin që fitimi duhet të njihet gjatë periudhës së kohës që mbulojnë kontratat, po kështu dhe me trajtimin e kontratave të tjera afatgjata të shërbimeve sipas IFRS-ve aktuale.

o Opsioni i dytë, klasifikimi i kapitalit të vet, do të jenë të dyja në përputhje me EPs dhe koherente me Solvency II, por mund të mos favorizohet nga IASB, për faktin se ata kanë treguar një synim për të eliminuar në mënyrë graduale lëvizjet në pasqyrën e bilancit, të cilat nuk kontrollohen nga pasqyra e të ardhurave/shpenzimeve.

o Propozimi i parë, klasifikimi i detyrimeve, është në përputhje me EPs (pa fitime në fillim) dhe me standardet e IASB. Për qëllime të aftësisë paguese, kjo zgjidhje nuk mund të jetë përfundimtare, sepse detyrimi kryesor, që është detyrimi ndaj policmbajtësve, nuk do të ndikohet nga marzhi i fitimit dhe mund të ndodhë një dhënie transparente e marzhit të fitimit.

o Forumi i CFO ka shprehur një preferencë për “klasifikimin e aftësisë paguese”, në atë nivel që kjo nuk do të mund të çenojë pozicionin e Solvency II.

Ndërlikimet e aftësisë paguese

Si Komisioni Evropian, ashtu dhe IAIS⁸, konsiderojnë që është më e pëlqyeshme të kenë llogaritës të detyrimeve në sigurime për qëllime të aftësisë paguese njësoj me ose në përputhje me llogaritjen sipas IFRS-ve (p.sh, mbikëqyrësit do të kërkojnë një rregullim për zbatimin e pjesës së mbetur të huave, nëse IFRS-të kërkojnë që të merret në konsideratë, në anën tjetër, mbikëqyrësit mund të kërkojnë të përfshijnë tek detyrimet të drejtat për pjesëmarrje në të ardhmen, nëse IFRS-të nuk do të lejojnë këtë gjë për njohjen si detyrim.

Industria është dakort me opinionin në të cilin pozicionohen mbikëqyrësit në favor të metodës së përputhshmërisë, për arsye që tashmë janë të qarta. Për vetë faktin se projekti Phase II është akoma në nivelin e DP, Komisionit Evropian iu desh të përshpejtonte llogaritjen e detyrimeve në sigurime në kolonën e parë të European Solvency II. Projekti është bazuar në metodën e pasqyrës së bilancit ekonomik. Siguruesit mbështesin vlerësimin e detyrimeve në sigurime në baza të vlerës së transferimit me “vlerë tregu” siç është propozuar në direktivën e cituar më sipër nën kuadrin e Solvency II⁹. Për risqe të mëdha, shuma e detyrimeve duhet të jetë e barabartë me vlerësimin më të mirë të flukseve të ardhshme të parasë e zbritur me një normë pa-risk plus një marzh risku e graduar me metodologjinë e kostos së kapitalit.

Propozimet e IAIS për llogaritjen e detyrimeve në sigurime janë pothuajse të ngjashme. Bazuar në parimin që “detyrime të njëjta me të njëjtin profil risku duhet të rezultojnë me detyrime të ngjashme”, IAIS mbështet përdorimin e vlerësimeve me vlerë tregu sa më shumë të jetë e mundur dhe beson që metoda sipas tre blloqeve siguron një metodologji të përshtatshme në mungesë të një tregu të mbikëqyrur për detyrimet në sigurime¹⁰.

Nëse marzhi i fitimit është përfshirë në kontabilizimin e detyrimeve, kjo llogari do të jetë më e lartë se shuma ekonomike që duhet të njihet për qëllime të Solvency II.

Ne kemi shprehur më sipër këndvështrimin që këto klasifikime të kontabilizimit të marzhit të fitimit nuk duhet të rrezikojnë pozicionin e Solvency II. Në veçanti, kjo nuk mund të frenojë mbikëqyrësit e sigurimeve që të vazhdojnë të njohin elementin e marzhit të fitimit si kapital i disponueshëm (Tier 1) dhe jo si kapital i përzier (hibrid) (Tier 2) për qëllime të aftësisë paguese, edhe pse ky element është klasifikuar si detyrim dhe jo si kapital.

Referenca:

DP – Discussion Paper (Material për diskutim)
IASB – International Accounting Standards Board
BSNK – Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

⁵ IASB (2007), § 99, “entry, primary or retail”.

⁶ IASB (2007), § 99 “exit, secondary or wholesale”.

⁷ Kjo siguron për riskun e tregut financiar në të njëjtën mënyrë si dhe BEL e propozuar nga IASB, dhe veç kësaj reflekton zbritjet për kostot e kapitalit të mbajtur dhe riskun jo-financiar që janë një përfaqësim i arsyeshëm për marzhin e riskut.

⁸ IAIS: Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime

⁹ Shiko nën-seksionin mbi marzhin e shërbimeve.

¹⁰ Shiko Studimin mbi “First Liabilities” (IAIS (2005)) dhe Studimin mbi “Second Liabilities” (IAIS (2006)), www.iaisweb.org.

Vijon në numrin tjetër...

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, A. Qamo, D. Papalilo,
L. Lloji, E. Basha, R. Eltari, E. Zalta, E. Kokona